

VENDIM
Nr.327, datë 31.5.2006

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË KOMUNËS QENDËR BULGAREC, TË QARKUT TË KORÇËS, TË SIPËRFAQES 4600 M² DHE OBJEKTIT “FJETINË, ZYRË, MENSË”, QË PËRFSHIHET BRENDA SAJ, KOMPONENTË TË PRONËS NR.550 “KOMPANIA E NDËRLIDHJES” BARÇ, KORÇË, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja 4600 m² dhe objekti “Fjetinë, zyrë, mensë”, që përfshihet brenda saj, komponentë të pronës nr.550 “Kompania e ndërlidhjes”, Barç, Korçë, me numër pasurie 368, në zonën kadastrale nr.1101, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, t’i kalojnë në pronësi komunës Qendër Bulgarec, për sistemimin e shkollës 9-vjeçare të fshatit Barç të qarkut të Korçës.

2. Kjo sipërfaqe dhe objekti “Fjetinë, zyrë, mensë” të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Komunës Qendër Bulgarec, të qarkut të Korçës, i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, të ndjekin procedurat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha